

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6308  
E premte, 7 maj 2021  
çmimi 0.40

## Pjesëmarrja e FSK-së në stërvitjen 'Defender Europe 21', ngjarje e rëndësishme



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"


AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SEANCA E MBAJTUR TË ENJTEN NË KUVENDIN E KOSOVËS KA NISUR ME PËRPLASJE NË MES TË POZITËS DHE OPOZITËS

### OPINION

#### KUJT PO I PENGON UÇK-JA?

Shkruan: Ismail TASHOLLI



### AKTUALE

#### NIS PUNA PËR PROCESIN E VETINGUT NË KOSOVË

#### PËRURORHET LAPIDARI I DËSHMORËVE DHE MARTIRËVE NË FSHATIN BELLE



### EKONOMI

#### KUVENDI VOTON PËR NDARJEN E 11 MILIONË EUROVE PËR RRYMËN NË VERI

#### KOSOVA NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME USAID-IN NË VLERË PREJ 1.6 MILION DOLLARËSH



## DEKLARATAT E GËRVALLËS NXITËN PËRPLASJE EDHE NË KUVEND



Me sharje, fyerje dhe shtyrje në mes të deputetëve të opozitës dhe atyre të pushtetit ka kaluar seanca e së enjtes mbajtur në Kuvendin e Kosovës. Disa deputetë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) janë përplasur me

ministrin e Bujqësisë, Faton Peci dhe me disa deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje. Incidentit i ka paraprirë një debat i ashpër në mes të deputetit të PDK-së, Abelard Tahiri, si dhe ministres së Punëve të Jashtme dhe të

Diasporës, Donika Gërvalla. Deputeti Tahiri e ka quajtur ministren Gërvalla "përfaqësuese e Serbisë në Kosovë", kurse kjo u ka thënë deputetëve të PDK-së se ata janë përgjegjës që prijësit e tyre sot ndodhen në Hagë

## DIALOGU ME SERBINË TË MOS NDËRLIDHET ME LIBERALIZIMIN E VIZAVE

Ministri i Punëve të Jashtme dhe Evropiane i Kroacisë, Gordan Grljiq Radman, ka konfirmuar mbështetjen për Kosovën në rrugën e saj evropiane dhe në procesin e liberalizimit të vizave. Kurse liderët



institucionalë të Kosovës i kanë kërkuar krydiplomati kroat që procesi i dialogut me Serbinë të mos ndërlidhet me liberalizimin e vizave për Kosovën. Sipas tyre, Kosovës duhet t'i jepet liberalizimi i vizave menjëherë sepse i ka përmbushur të gjitha kriteret

## BILALL SHERIFI: DUAM TË DIMË NËSE MBROJTJA E PËRFAQËSUESVE TË UÇK-SË ËSHTË PUNË QEVERIE EDHE TANI, KUR KURTI UDHËHEQ QEVERINË



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## ShBA-ja rikonfirmon mbështetjen për 'sovrانيتetin dhe integritetin territorial' të Ukrainës

UASHINGTON, 6 MAJ - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka rikonfirmuar përkushtimin e Uashingtonit për sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë e Ukrainës. "Jam këtu për një arsye shumë të thjeshtë, që në emër të presidentit (amerikan, Joe) Biden ta rikonfirmoj fuqishëm përkushtimin tonë ndaj sovranitetit, integritetit territorial dhe pavarësisë së Ukrainës", ka thënë Bideni më 6 maj. Vizita njëditore e Blinkenit synon të dërgojë mesazh të qartë për mbështetje të këtij vendi në kohën e rritjes së

tensioneve me Rusinë.

Blinken ka thënë përmes një postimi në "Twitter" më 5 maj se vizita "do të jetë mundësi e rëndësishme për ta diskutuar agresionin e vazhdueshëm të Rusisë dhe për ta theksuar nevojën për ruajtje të fokusit në reforma me partnerët tanë ukrainas".

Gjatë vizitës së tij më 6 maj, diplomati amerikan do ta takojë presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskiy, ministrin e Jashtëm Dmytro Kuleba, anëtarë të Parlamentit të Ukrainës dhe pjesëtarë të shoqërisë civile.

Zelenskiy ka thënë se dëshiron të dëgjojë sinjale të forta nga Shtetet e Bashkuara për mbështetje të dëshirës së Ukrainës për anëtarësim në NATO.

Në një deklaratë të lëshuar më 5 maj nga Departamenti amerikan i Shtetit, Uashingtoni nuk ka përmendur aspiratat e Ukrainës për NATO, mirëpo ka thënë se Shtetet e Bashkuara vazhdojnë ta monitorojnë situatën sa iu përket "veprimeve agresive të Rusisë dhe retorikës që shënjestron Ukrainën".

Ukraina pritet të kërkojë më shumë ndihmë ushtarake nga



Shtetet e Bashkuara. Deklarata e autoriteteve amerikane vë në pah se nga viti

2014 Shtetet e Bashkuara i kanë dërguar Ukrainës ndihmë në vlerë të 4.6 miliardë dollarëve.

## OKB-ja: 155 milionë persona janë përballur me uri vitin e kaluar



NJU-JORK, 6 MAJ - Nivele të thella të urisë kanë prekur të paktën 155 milionë persona vitin e kaluar si rezultat i konflikteve, dëmeve ekonomike të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit dhe moti ekstrem, derisa situata këtë vit është e njëjtë ose edhe më e ashpër, është thënë në një raport të përpiluar nga 16 organizata.

Dy të tretat e njerëzve që janë përballur me këtë krizë janë nga 10 shtete: Afganistan, Jemen, Siri, Sudan, Kongo, Nigeri veriore, Etiopi, Sudan Jugor, Zimbabve dhe Haiti. Të 155 milionë personat

përballen me "krizë", "emergjencë" apo me nivele katastrofike të urisë, çka përbën rritje prej 20-përqindësh të numrit të personave që janë përballur me diçka të tillë, krahasuar me vitin 2019, ka thënë raporti. "Numri i personave që përballen me pasiguri të thellë në ushqim dhe kërkojnë urgjentisht ushqim dhe ndihmë për jetesë është duke u rritur", ka thënë sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, teksa ka paraqitur Raportin Global për Krizë Ushqimore. "Në shekullin 21 nuk ka vend

për uri", ka thënë Guterres. "Neve na duhet ta luftojmë urinë dhe konfliktin, për ta zgjidhur njërën apo tjetrin problem", është shprehur ai.

Raporti, që mbulon 55 shtete, po ashtu ka thënë se 133 000 njerëz në Burkina Faso, Sudanin Jugor dhe Jemen kanë nevojë urgjente për ushqim për t'i parandaluar vdekjet nga uria.

Ekonomisti kryesor në Programin Botëror të Ushqimit, Arif Husain, ka thënë në një konferencë për media në OKB, se konfliktet nxisin më së shumti krizën me ushqim.

## Prototipi i SpaceX zbarkon me sukses në fluturimin testues

UASHINGTON, 6 MAJ - Prototipi SN15 i anijes hapësinore të gjeneratës së re Starship, të cilën kompania amerikane e hapësirës dhe aviacionit SpaceX po planifikon ta dërgojë në Mars, zbarkoi me sukses në fluturimin testues. Prototipi SN15 i Starship fluturoi rreth 10 minuta në

lartësi të madhe në përpjekjen e tij të pestë.

Duke arritur një lartësi prej 10 kilometrash pasi u ngrit nga toka në fluturimin testues në Gjirin e Meksikës, SN15 filloi të ulej.

Starship zbarkoi me sukses. Pjesa e sipërme e pistës ku ra anija u lag me ujë në

mënyrë që të mos shkaktonte zjarr.

Fluturimet e mëparshme testuese të anijes më 9 dhjetor 2020 dhe 2 shkurt, 3 mars dhe 6 prill rezultuan në një shpërthim gjatë uljes.

SpaceX synon të përdorë Starship në ekspeditat me njerëz në Hënë dhe Mars.



## Opozita greke, protestë paqësore në Athinë



Athinë, 6 maj - Në kuadër të protestave të 1 majit, opozita greke ka organizuar protesta në qendër të Athinës për t'i kundërshtuar reformat e qeverisë Mitsotakis në ekonomi, skemën e pensioneve, por edhe për mënyrën e menaxhimit të pandemisë. Me pjesëmarrjen

e liderit të opozitës Aleksis Tsipras, protestuesit hodhën parulla kundër qeverisë. Ata kërkuar përmirësim të kushteve të punës, rritje të të ardhurave dhe pakësim të taksave.

Protesta u mbështet nga sindikata e përgjithshme e punonjësve grekë si dhe nga

shoqatat e emigrantëve pakistaneze dhe ata bangladeshas. Si pasojë e grevës metroja dhe trenat e Athinës nuk do të funksionojnë, ndërsa asnjë anije mallrash ose pasagjerësh nuk do të përpunohet në portet e vendit.

KRYEDIPLOMATI KROAT GORDAN GRLIQ RADMAN KA VIZITUAR KOSOVËN

# Dialogu me Serbinë të mos ndërlihet me liberalizimin e vizave

Ministri i Punëve të Jashtme dhe Evropiane i Kroacisë, Gordan Grliq Radman, ka konfirmuar mbështetjen për Kosovën në rrugën e saj evropiane dhe në procesin e liberalizimit të vizave. Kurse liderët institucionalë të Kosovës i kanë kërkuar kryediplomatit kroat që procesi i dialogut me Serbinë të mos ndërlihet me liberalizimin e vizave për Kosovën. Sipas tyre, Kosovës duhet t'i jepet liberalizimi i vizave menjëherë sepse i ka përmbushur të gjitha kriteret



Qeverisë së Kroacisë për dhënien e një donacioni prej 10 000 dozave të vaksinave kundër koronavirusit për Republikën e Kosovës. Besojmë se ky donacion do të jetë i mirë për mbrojtjen e njerëzve", ka thënë ai.

Ai nuk e ka përmendur se vakcina e cilës kompani do t'iu dorëzohet autoriteteve të Kosovës.

Kryediplomatit kroat e ka takuar edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili e ka falënderuar ministrin Radman dhe Kroacinë për bashkëpunimin e mirë dhe për mbështetjen e vazhdueshme të Kroacisë ndaj Republikës së Kosovës. Ai shprehu falënderimin dhe mirënjohjen e sinqertë për donacionin prej 10 mijë vaksinash, duke e vlerësuar si lajm që sjell optimizëm dhe shpresë për shtimin e vaksinimit para muajve të verës, kur mërgata kthehet për pushime në Kosovë. Kurti dhe Radman kanë diskutuar edhe për avancimin e marrëdhënieve bilaterale në mes të dy vendeve. Duke spikatur raportet e shkëlqyera ndërmjet dy vendeve, ministri Radman ka siguruar Kurtin se Kroacia do të vazhdojë ta përkrahë dhe ta ndihmojë Republikën e Kosovës në procesin e integrimi evropiane dhe euroatlantike. Ai ka kërkuar shtimin e marrëdhënieve bilaterale.

**EPOKA ERE**

Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 6 MAJ** - Ministri kroat për punë të Jashtme dhe Çështje Evropiane, Gordan Grliq Radman, ka shprehur gatishmërinë e tij për ta mbështetur Kosovën në rrugën e saj evropiane.

Gjatë takimit me zyrtarët më të lartë shtetërorë të Kosovës ai ka thënë se Kroacia promovon Kosovën në arenën ndërkombëtare dhe e përkrah plotësisht integrimin e saj euroatlantik.

Ndërsa liderët institucionalë të Kosovës kanë kërkuar nga kryediplomati kroat mbështetje në procesin e liberalizimit të vizave.

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në takimin me diplomatit kroat, ka kërkuar që procesi i dialogut me Serbinë nuk duhet

ndërlihet me liberalizimin e vizave. Ajo ka thënë se Kosova tashmë ka plotësuar kriteret për liberalizim vizash pavarësisht se ka pasur dyfish kriteret më shumë sesa vendet e tjera. "Kosovës duhet t'i jepet liberalizimi i vizave menjëherë sepse Kosova i ka plotësuar kriteret, ndërkaq BE-ja duhet ta mbajë premtimin e jo ta konsiderojë liberalizim si peng të proceseve të tjera", ka theksuar presidentja Osmani, sipas njoftimit të Presidencës. Ndërkaq ministri Radman ka potencuar se shteti i tij e ka mbështetur dhe do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në rrugën evropiane si dhe në procesin e liberalizimit të vizave.

Radman mbështetjen për Kosovën ia ka rikonfirmuar edhe ministres së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës të Kosovës, Donika Gërvalla.

"Kroacia është aktive në promovimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe e përkrah plotësisht integrimin e saj euroatlantik. Gjithashtu e mbështesim anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare", ka deklaruar në një konferencë të përbashkët për media me Gërvallën. Për më tepër, ai ka shprehur gatishmërinë që të ketë bashkëpunim të rregullt midis dy vendeve për tema të ndryshme dhe të ofrohet përkrahja e Kroacisë lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për Kosovën.

Kurse ministrja Gërvalla e ka falënderuar homologun kroat për ndihmën e vazhdueshme që Kroacia i ka ofruar Kosovës nëpër të gjitha fazat e shtetndërtimit, duke theksuar raportet e shkëlqyera që kanë dy vendet, miqësinë dhe

bashkëpunimin bilateral në shumë fusha. "Për Kosovën mbetet thelbësor avancimi në procesin e integritit euroatlantik. Në këtë drejtim njohuritë dhe përvoja e Kroacisë është shumë e vlefshme për ne dhe jemi të përkushtuar ta thellojmë bashkëpunimin dhe shkëmbimet në këtë drejtim", ka thënë Gërvalla.

## Kroacia ia dhuron Kosovës 10 mijë doza të vaksinës kundër Covidit

Gjatë vizitës në Kosovë, ministri kroat për Punë të Jashtme dhe Çështje Evropiane, Gordan Grliq Radman, ka njoftuar se Kroacia ka ndarë për Kosovën 10 000 vakcina kundër koronavirusit. "Me kënaqësi të veçantë e kam informuar zonjën ministre rreth vendimit të

# Pjesëmarrja e FSK-së në stërvitjen 'Defender Europe 21', ngjarje e rëndësishme

**PRISHTINË, 6 MAJ (ER)** - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, dhe komandanti i FSK-së, gjeneraljtënant Rrahman Rama, kanë mbajtur të enjten konferencë për media në lidhje me stërvitjen "Defender Europe 21", në të cilën do të marrë pjesë edhe FSK-ja.

Ministri Mehaj në fjalën e tij ka paraqitur rëndësinë e këtij ushtrimi për FSK-në dhe Kosovën, duke theksuar faktin se bashkëpunimi i FSK-së në një ushtrim të përmasave të tilla me ushtrinë e ShBA-së, aletit tonë kryesor strategjik dhe vendeve të tjera aleate, është një ngjarje shumë e rëndësishme. "Kjo stërvitje ka ndikim të jashtëzakonshëm në mjedisin e sigurisë rajonale në Ballkanin Perëndimor dhe shpreh



fuqishëm qëllimin strategjik dhe përkushtimin e ShBA-së dhe aleatëve të saj, në mesin e tyre edhe të Kosovës, për një Ballkan dhe Evropë në paqe, siguri dhe stabilitet", ka thënë ai.

Mehaj ka thënë se stërvitja "Defender Europe 21" na ofron mundësinë më të mirë për t'i rritur aftësitë tona së

bashku me ShBA-në dhe aleatët e partnerët e tjerë në mënyrë që të jemi të gatshëm t'i përgjigjemi çdo lloj krize. "Pjesëmarrja e Kosovës në këtë stërvitje si vend partner i ShBA-së është ngjarje e rëndësishme që dëshmon përkushtimin e Republikës së Kosovës për paqen, sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe

më gjerë, përmes gatishmërisë dhe ndërveprimit ushtarak të FSK-së me forcat amerikane dhe forcat e vendeve partnere", ka deklaruar ministri Mehaj.

Ndërsa komandanti i FSK-së, Rrahman Rama, është përqëndruar tek objektivat e ushtrimit, nivelin e përgatitjeve, gatishmërinë e trupave për ndërveprim dhe koordinim me ushtritë e tjera në terren dhe objektivat që priten të arrihen. "Ky ushtrim ka për qëllim ta ndërtojë gatishmërinë operacionale dhe ndërveprueshmërinë mes të gjithë aleatëve dhe partnerëve. Përfshirja e FSK-së në këtë ushtrim ka domethënie të madhe. Pjesëmarrja e FSK-në në këtë ushtrim ngrit aftësitë e personelit tonë për kryerjen e

detyrave. Pjesëmarrja në këtë ushtrim demonstroi aftësinë e vendit për të shërbyer si partner strategjik i sigurisë në regjion dhe më gjerë. FSK-ja do të vazhdojë të jetë pjesë e ushtrimeve dhe trajnimeve ndërkombëtare për t'i ngritur aftësitë e veta operacionale dhe të jetë e ndërveprueshme me partnerë", ka thënë Rama. Kosova në këtë ushtrim do të jetë në mesin e 16 vendeve pritëse. FSK-ja është e përfshirë me 330 pjesëtarë. Pjesa kryesore e ushtrimit do të realizohet nga data 17 deri 29 maj 2021. Komanda e Lartë (HICON) dhe Audiencia Sekondare do të jenë të vendosura në Aeroportin e Gjakovës, kurse Ushtrimi Fushor do të realizohet në zonën e trajnimit në "Babaj të Bokës" në Komunën e Gjakovës.



SEANCA MBAJTUR TË ENJTEN NË KUVENDIN E KOSOVËS KA NISUR ME PËRPLASJE  
NË MES TË POZITËS DHE OPOZITËS

# Deklaratat e Gërvallës nxitën përplasje edhe në Kuvend

Me sharje, fyerje dhe shtyrje në mes të deputetëve të opozitës dhe atyre të pushtetit ka kaluar seanca e së enjtes mbajtur në Kuvendin e Kosovës. Disa deputetë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) janë përplasur me ministrin e Bujqësisë, Faton Peci dhe me disa deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje. Incidentit i ka paraprirë një debat i ashpër në mes të deputetit të PDK-së, Abelard Tahiri, si dhe ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla. Në fjalën e tij, deputeti Tahiri e ka quajtur ministren Gërvalla “përfaqësuese të Serbisë në Kosovë”, kurse kjo u ka thënë deputetëve të PDK-së se ata janë përgjegjës që prijësit e tyre sot ndodhen në Hagë

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 MAJ - Me sharje, fyerje dhe shtyrje në mes të deputetëve të opozitës dhe atyre të pushtetit ka kaluar seanca mbajtur të enjten në Kuvendin e Kosovës. Për rritjen e tensioneve shërbeu një deklaratë e dhënë për media vite më parë nga Donika Gërvalla, sot ministre e Punëve të Jashtme e Kosovës, për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe për ish-krerët e PDK-së, Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin, të cilët i kishte quajtur njerëz të krimt.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, në fjalën e tij në Kuvend, e ka quajtur ministren Gërvalla “përfaqësuese e Serbisë në Kosovë”. “Ti je përfaqësuese e Serbisë në Kosovë. Ti nuk më përfaqëson mua. Ti je turpi më i madh. Po të kishim një kryeministër të përgjegjshëm, sot do të duhej t’ju shkarkonte. As edhe një minutë t’i nuk mund të jesh ministre e Punëve të Jashtme”, ka thënë Tahiri. Por vetë ministrja e Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, i ka akuzuar deputetët e PDK-së se janë fajtorët kryesorë që kanë ndihmuar për

formimin e Dhomave të Specializuara. “Ju pikërisht jeni përgjegjës që prijësit tuaj sot ndodhen në Hagë. Ju, duke mohuar të vërtetën, nuk do ta zgjidhni këtë çështje. Bëhuni seriozë, bëhuni opozitë serioze dhe konfrontohuni me të vërtetën tuaj dhe mos mashtroni votuesit tuaj”, ka deklaruar ministrja Gërvalla. Ky debat shkaktoi sharje dhe fyerje në mes të deputetëve të pushtetit dhe të opozitës. Të pakënaqur me zhvillimin e punimeve në Kuvend, deputetët e PDK-së, Memli Krasniqi, Ardian Kastrati dhe Hajdar Beqa, u përfshinë në një

situatë të tensionuar me ministra dhe deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje. Derisa deputetët e PDK-së po lëshonin sallën në shenjë proteste ata u përplasën me ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, i cili i doli në mbrojtje ministres Gërvalla. Në këtë fjalosje u përfshi edhe ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, si dhe disa deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje, përfshirë Salih Zybën dhe deputetin e ri, Besim Muzaqi. Përplasja dhe shtyrjet në mes të deputetëve të pushtetit dhe opozitës zgjatën disa minuta derisa kjo çoi në ndërprerje të seancës së Kuvendit. Para se të ndodhte ky incident, seancën e lëshuan edhe deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ata kundërshtuan mënyrën se si nënkryetarja e kuvendit, Saranda Bogujevci, po e udhëhiqte seancën. Bugujevci u ballafaqua me shefin e grupit parlamentar të

LDK-së, Arben Gashi. Pas ndërprerjes së seancës, Mimoza Kusari, që udhëheq grupin parlamentar të LV-së, ka thënë se provokimet dhe fyerjet ishin të rënda nga deputetët e PDK-së. “Sot ishim dëshmitarë të skenave joparlamentare, të papranueshme për një demokraci, për një vend në të cilin në parlament duhet të debatohet, diskutohet, mund edhe të mos pajtohemi natyrisht, kemi pozitë e opozitë, por jo edhe të fyhemi, shahemi e deri tek ofendimet dhe kërcënimet, të cilat sot u dëgjuan nga deputetët të Partisë Demokratike të Kosovës”, ka thënë ajo. Kusari-Lila ka thënë se seanca nga fillimi ka nisur me tensione përmes deklaramëve për tema jashtë rendit të ditës. Ndaj deklaratës së Kusari-Lilës ka reaguar deputeti i PDK-së, Memli Krasniqi. “Mimoza Kusari-Lila, kjo zëdhënëse e përjetshme e pushtetit, duke u munduar që ta heqë vëmendjen prej tentimit të sotëm të grupit të saj për ta

heshtur dhunshëm opozitën në Kuvend, e besa edhe për të na sulmuar fizikisht, paska shpifur kundër meje, se kinse e paskam ofenduar atë dhe koleget e saj. Siç ndodh rëndomë, të ligët, kur s'kanë argumente, shpifin. Përveç nëse Mimoza ofendohet nga fjala 'analfabet'. Nëse po, atëherë vërtet e paskam 'ofenduar' ministren Shwartz. Sepse ajo është absolutisht analfabete funksionale në lëmin e diplomacisë, gjë që po e shpërfaq çdo ditë në mënyrën më të turpshme, duke e goditur çdo vlerë të popullit e të shtetit tonë, sikur të ishte ministre e Serbisë e jo e Kosovës", ka thënë Krasniqi.

### PKD-ja kërkon shkarkimin e ministres Gërvalla

Pas zhvillimeve në seancën e së enjtes, shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka mbajtur konferencë për media lidhur me

narracionin e përdorur nga ministrja e Jashtme, Donika Gërvalla-Schwarz, për luftën çlirimtare. Ai ka kërkuar nga kryeministri Albin Kurti ta shkarkojë atë nga pozita e ministres sa më parë. "Edhe sot ishit dëshmitarë të angazhimit të ministres Schwarz për denigrimin e luftës çlirimtare të Republikës së Kosovës. Ajo edhe sot vazhdoi ta fyente luftën e UCK-së, kauzën e cila solli lirinë dhe pavarësinë e këtij vendi. Ajo edhe sot i fyeu viktimat të cilat ranë për lirinë dhe pavarësinë e këtij vendi. Ajo i fyeu të gjitha gratë e dhunuara në Republikën e Kosovës gjatë luftës së vitit 1998/99. Ajo sot fyeu sakrificën më të madhe të kombit shqiptar në shekullin XX. Prandaj, ne si PDK nuk mund të lejojmë që ministrja e Punëve të Jashtme të flasë me narracionin e ndërtuar në Beograd", ka thënë Tahiri. Ai ka thënë se narracioni i ministres Gërvalla-Schwarz ishte i njëjtë me atë të kasapit të

Ballkanit, Sllobodan Millosheviq dhe përfaqësuesit të tij Ivica Daçiç. "Kërkojmë nga z. Kurti që sa më parë ta shkarkojë këtë ministre të papërgjegjshme, këtë ministre që në vazhdimësi fyen vlerat më të larta kombëtare të popullit shqiptar, ta shkarkojë këtë njeri e cila në mënyrë të vazhdueshme e denigron pjesën më të ndritur të historisë tonë kombëtare", ka thënë ai. Më tutje, ai ka theksuar se ishte e pamundur që deputetët e PDK-së të qëndrojnë në seancën plenare ku do të diskutohej për organizimin e arsimit në pandemi për shkak të fyerjeve dhe ofendimeve nga deputetët e mazhorancës. "Në vazhdimësi ka tendencë për ta ndalur fjalën e deputetëve të opozitës, për t'ua pamundësuar atyre që t'i ngrehin çështjet për të cilat u kanë dhënë vota qytetarët e Kosovës. Prandaj një mënyrë e tillë e sjelljes nga nënkryetarja e Kuvendit është e

papranueshme. I bëjmë thirrje kësaj mazhorance të papërgjegjshme të tërhiqet nga ky pozicion", ka thënë ai. Tahiri ka kërkuar nga kryetari i Kuvendit të ftojë mbledhje urgjente të kryesisë dhe aty të vendoset për kohën e vazhdimet të seancës.

### Gashi për deklaratat e Gërvallës: Të tepruara dhe të panevojshme

Shefi i deputetëve i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Arben Gashi, ka kritikuar fjalimin e ministres së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla, që mbajti të enjten në Kuvend. Në një konferencë për media, ai ka thënë se fjalimet e tilla janë të panevojshme. "Mendoj se janë deklaratime të tepruara dhe të panevojshme. Ato deklaratime në atë mënyrë dhe gjuhë në Kuvendin e Kosovës rrallëherë janë dëgjuar. Mendoj se Kuvendit i duhen më shumë qetësia,

demokracia dhe liria, e jo absolutizmi i shprehur nga foltorja e Kuvendit apo pozita e ministrave apo qeveritarëve. Jemi në një proces ku duhet të jemi të kujdesshëm e, mbi të gjitha, duhet të jemi të kujdesshëm për rastet që kanë të bëjnë me krimet e luftës dhe personat që janë arrestuar", ka deklaruar Gashi.

Në seancën e 6 majit të Kuvendit të Kosovës ishte planifikuar që të shqyrtoheshin rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në lidhje me kërkesën e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve në pjesën veriore të Kosovës.

Pas kthimit të deputetëve të pozitës në seancë, pa opozitën, me 61 vota kanë kaluar rekomandimet për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës.

## Tre të vdekur dhe 158 raste të reja me Covid në Kosovë



### EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 MAJ - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe

laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 2 193 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 158 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar tri raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjilan tri raste (79, 78, 76 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 106 022 raste nga 546 741 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 2 198 raste të

vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 346 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 96 668 raste, kurse numri i rasteve aktive është 7 156.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 22 raste, Vushtrri 20 raste, Mitrovicë 17

raste, Skenderaj 16 raste, Gjilan 11 raste, Lipjan 11 raste, Gjakovë 10 raste, Ferizaj 8 raste, Pejë 8 raste, Drenas 7 raste, Istog 5 raste, Viti 5 raste, Obiliq 4 raste, Deçan 3 raste, Fushë-Kosovë 2 raste, Klinë 2 raste, Malishevë 2 raste, Rahovec 2 raste, Kaçanik 1 rast, Podujevë 1 rast, Prizren 1 rast.

## Në muajin shtator organizohet në Gjakovë ushtrimi "Shpata e Argjendtë"

GJAKOVË, 6 MAJ (ER) - Në shtator të këtij viti në Komunën e Gjakovës do të mbahet ushtrimi "Shpata e Argjendtë", aktivitet ky që organizohet nga FSK-ja,

KFOR-i, Policia e Kosovës dhe AME. "Pata kënaqësinë që t'i pres në takim për gatitor oficerët e KFOR-it, FSK-së, Policisë, përfaqësuesit e AME dhe

ata të Kryqit të Kuq. Ky ushtrim do të jetë i mirëseardhur për rritjen e kapaciteteve lokale dhe nacionale për menaxhimin e emergjencave. Jam i

lumtur që ushtrimi 'Shpata e Argjendtë' do të zhvillohet edhe në Gjakovë", ka thënë kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini.



## Në përvjetorin e rënies, nderohet dëshmori Artim Jashari



MITROVICË, 6 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i shoqëruar nga nënkryetari Faruk Mujka, dhe së bashku me kryetarin e Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, me bashkëpunëtorë, përfaqësues të institucioneve të tjera të Mitrovicës, si dhe familjarë, të enjten kanë nderuar dëshmorin e kombit Artim Jashari, me rastin e 23-vjetorit të rënies së tij te sheshi "Artim Jashari", afër Stacionit të

Autobusëve në Mitrovicë. Në fjalën e tij, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka thënë se në këtë ditë po e nderojnë heroin kombëtar Artim Jashari, i cili ka sakrifikuar jetën për lirinë dhe pavarësinë e vendit që ne po e gëzojmë sot. "Ajo çfarë na mbetet neve si institucione qoftë nga niveli lokal apo ai qendror, është që të punojmë sa më shumë dhe t'i ndihmojmë këtij vendi si dhe qytetarëve të saj, në mënyrë

që amaneti i dëshmorëve tanë të dërgohet në vend të duhur", ka deklaruar Bahtiri. Në shenjë nderimi dhe kujtimi për veprën heroike të këtij dëshmori, kryetari Bahtiri, së bashku me bashkëpunëtorët dhe kryetarin e Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, por edhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera, bënë homazhe dhe vendosën kurora me lule te lapidari i Artim Jasharit.

## Përurohët lapidari i dëshmorëve dhe martirëve në fshatin Belle

DEÇAN, 6 MAJ (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në përrurimin e lapidarit të dëshmorëve dhe martirëve në fshatin Belle të Deçanit. "Të mirat e lirisë janë të shumta. Sot jetojmë të lirë dhe kemi mundësi ta respektojmë rrugën tonë të gjatë, rrugën e luftëtarëve tanë ndër breza. Është nder i madh që më në fund na erdhi dita të gjithëve t'i nderojmë të rënë të ndër

shekuj. Na erdhi dita që t'i shohim njerëzit, edhe pse të shpërndarë anekënd Kosovës, me i pa te rrënjët e veta", ka thënë lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ai ka theksuar se rruga që lidh Bellen me Plavën, na lidh edhe me sakrificën ndër breza, dhe secila trevë ka një histori, ndërsa Belle ka një histori të veçantë sepse nga këtu ishte komandanti i shquar Sali Çeku. "Kthimi te rrënjët për ne shqiptarët është identifikim

yni sikurse që ndodhi në vitin '99. Kjo rrugë që na lidh me Plavën, na lidh edhe me sakrificën tonë që dikur nuk ka qenë e ndarë me kufij, shqiptarët kanë jetuar në këto treva dhe në cilëndo prej tyre ka një histori, ndërsa historia e Belles është e veçantë. Nga këtu e kemi komandantin e shquar, Sali Çeku, një hero i kombit me të cilin mburremi, sikurse me të gjithë dëshmorët e tjerë", ka thënë Haradinaj.



## Malisheva bën përgatitjet për fillimin e dezinfektimit kundër rriqrave



MALISHEVË, 6 MAJ (ER) - Shtabi komunal për menaxhimin e situatës me endeminë e Etheve Hemorragjike Krime Kongo (EHKK) në Komunën e Malishevës të enjten ka mbajtur takimin e radhës, ku është shqyrtuar situata me EHKK dhe përgatitjet për fillimin e dezinfektimit kundër rriqrave, si një nga masat parandaluese për luftimin dhe parandalimin e EHKK-së. Në këtë takim ishin të pranishëm nënkryetari i Komunës së Malishevës,

Hajdin Berisha, drejtori për Shëndetësi, Liridon Hoti, drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Hafir Rexha, koordinatori i Shtabit, Halit Mazreku dhe përfaqësuesi i kompanisë që do ta bëjë dezinfektimin në territorin e Malishevës. Në këtë takim u vlerësua se situata aktualisht është e qetë dhe në kontroll të plotë, por për mbajtjen në kontroll të kësaj duhet të merren edhe masat parandaluese, të cilat janë kompetencë e komunës. Për këtë qëllim janë bërë të

gjitha përgatitjet për fillimin e fushatës së dezinfektimit, e cila pritet të fillojë së shpejti. Edhe në këtë takim shtabi komunal emergjent ka shprehur pakënaqësinë lidhur me moszhvillimin e procesit të repelimit të kafshëve, që është kompetencë e Ministrisë së Bujqësisë, përkatësisht Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, që tani e tri vjet me radhë nuk janë duke realizuar repelimin e kafshëve, e që konsiderohet si masa më efektive për luftimin dhe parandalimin e EHKK-së.

## Përurohët ura në Dobroshec të Drenasit

Drenas, 6 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me zëvendëskomandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralmajor Enver Cikaqi dhe pjesëtarë të tjerë të FSK-së, kanë përruruar të enjten urën në fshatin Dobroshec, pas dëmtimeve që kishte pësuar ura e vjetër si pasojë e

reshjeve të mëdha të shiut gjatë muajit janar të këtij viti. Kryetari Lladrovci ka falënderuar Forcën e Sigurisë së Kosovës e cila ka ndihmuar për ndërtimin e kësaj ure të përkohshme dhe ka vlerësuar se me ndërtimin e kësaj ure do t'u lehtësohet qarkullimi banorëve, ku për më shumë se dy muaj e kanë pasur të

vështirësuar qarkullimin për shkak të dëmtimit të urës nga vërshimet. Ndërtimi i kësaj ure mobile është bërë nga inxhinierët e Regjimentit Xhenios të Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës "Mabey Johnson" në bashkëpunim me Komunën e Drenasit.



## Osmani dhe Kurti bëjnë homazhe te varri i Fehmi Aganit

PRISHTINË, 6 MAJ (ER) - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë bërë homazhe të enjten te varri i Fehmi Aganit, në 22-vjetorin e vrasjes së tij, ndërsa kanë kërkuar drejtësi për të gjitha viktimat në Kosovë nga regjimi gjenocidal i Serbisë. "Sot e kujtuam njeriun e urtë e veprimtarin e madh, bashkudhëtarin politik të arkitektit të pavarësisë së Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, njeriun e dijeve e të ideve për konsolidimin e shtetit, profesor Fehmi Aganin. Ai u vra më 6 maj 1999 nga regjimi gjenocidal serb i Millosheviqit. Vrasja e tij qe përpjekje për ta dobësuar vullnetin dhe këmbëngulësinë e shqiptarëve për liri dhe pavarësi", ka thënë Osmani.

Ajo ka theksuar se Agani tërë jetën e kaloi në përpjekje për përjetësimin e idealeve të brezave të tërë për liri e pavarësi të Kosovës. "Profesor Agani luftoi tërë jetën për

idealin e shqiptarëve për liri dhe e mbajti të gjallë vazhdimisht ëndrrën për ta parë të jetësuar atë", ka deklaruar presidentja Osmani. Kryeministri Kurti tha se sot në 22-vjetorin e rrëmbimit dhe vrasjes kriminale të profesor Fehmi Aganit, vendosen lule të freskëta te varri i tij dhe bënë nderim për figurën e tij, roli dhe kontributi i të cilit është i madh. Si profesor, akademik dhe intelektual, Fehmi Agani, siç u shpreh kryeministri Kurti, kishte formim të thellë social dhe të lartë humanist, ndërkaq si veprimtar politik dhe si politikan udhëheqës ai ishte paqësor për nga karakteri dhe përparimtar për nga synimi.

Në 22-vjetorin e vrasjes së Fehmi Aganit, Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" ka kërkuar që të ngritet padi penale kundër vrasësve të Fehmi Aganit. "Qendra 'Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur' kërkon që institucionet e drejtësisë së Kosovës të



ngrenë padinë penale kundër Predrag Nikoliq dhe Zoran Dzeletoviq për vrasjen e Fehmi

Aganit dhe të pesë anëtarëve të familjes Blakçori dhe t'i shtojnë përpjekjet për

ndëshkimin e krimit të gjenocidit në Kosovë", thuhet në deklaratën e kësaj qendre.

## Nis puna për procesin e vetingut në Kosovë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 MAJ - Nën organizimin e Ministrisë së Drejtësisë, është mbajtur të enjten takimi i parë i Grupit Punues për hartimin e konceptdokumentit për procesin e vetingut.

Të pranishëm në këtë takim ishin anëtarët e Grupit Punues, njëkohësisht përfaqësuesit nga institucionet e drejtësisë: Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, institucionet e tjera, organizatat e shoqërive civile dhe ekspertë të pavarur të cilët kanë shprehur paraprakisht gatishmërinë për të kontribuar në këtë drejtim.

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka shprehur falënderimet për pjesëmarrjen e anëtarëve të grupit punues, duke uruar njëkohësisht që bashkërisht të jetësohen përpjekjet që ky proces të realizohet në mënyrë të suksesshme, përkundër sfidave që ka dhe, rrjedhimisht, të thellohet besimi i qytetarëve tek institucionet e drejtësisë.

Ministrja Haxhiu ka potencuar se gjyqësori është komponentë e rëndësishme e sundimit të ligjit të çdo shteti dhe se pamundësia e sistemit gjyqësor dhe



prokurorial të veprojnë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë ndaj të gjithë qytetarëve, shpie tek etablimi i kulturës së mosndëshkimit, që shtyp zërin e qytetarëve. "E kjo është dukuri që ne, si Qeveri e Republikës së Kosovës, nuk mund të lejojmë të ndodhë.

Fatkeqësisht, besimi i publikut në sistemin gjyqësor dhe prokurorial nuk është dëshmuar të jetë në nivelin e pritshmërive. Kjo nuk rëndon vetëm sistemin gjyqësor e

prokurorial, por edhe vetë Qeverinë e Republikës së Kosovës e cila është e përkushtuar, me tërë fuqinë e saj, për realizimin e plotë të të drejtave të qytetarëve ashtu si u janë garantuar me Kushtetutë dhe me ligjet e Republikës së Kosovës", ka thënë Haxhiu.

Këtë takim ministrja e cilësoi si simbol të nisjes së ndryshimeve pozitive brenda sistemit të drejtësisë dhe i inkurajoi të gjithë që të përkushtohen me tërë kapacitetet që t'i lënë trashëgimi

të duhur atyre që vijnë pas, po ashtu ta kthejnë besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Po në këtë takim është bërë paraqitja e strukturës përmbajtjesore të koncept dokumentit dhe planit fillestar të punës nga Lulzim Beqiri, kryesues i grupit punues, e cila pritet të përfundojë brenda katër muajve.

Në anën tjetër të pranishmit në takim, përfaqësues nga

institucionet dhe shoqëria civile, shprehën vullnetin dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në këtë proces të rëndësishëm reformues në sistemin e drejtësisë.

Në fund të takimit anëtarët e grupit punues u pajtuan rreth planit të punës dhe formatin mbi bazën e të cilit do të përgatitet ky koncept dokument si dhe fazat nëpër të cilat do të kalojë deri në miratimin e tij në qeveri.

## Gjinekologët e QKUK-së kryejnë një operacion të rëndë

Prishtinë, 6 maj (ER) - Gjinekologët e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, në bashkëpunim me ekipin e

anesteziologëve, kanë kryer një operacion të rrallë të karcinomës së dyanshme të ovareve, Stadi II, te një paciente e moshës 38-

vjeçare. "Ky është një ndër tumoret malinjë më të shpeshta të gjinisë femërore e që, nëse identifikohet me kohë, suksesi përmes

operacionit është shumë më i lartë", ka njoftuar QKUK-ja. Pacientja do të vazhdojë edhe për disa ditë trajtimin në këtë klinikë.



## Kujt po i pengon UÇK-ja?



Shkruan: Ismail  
TASHOLLI

Më 29 janar 2001 në një gazetë të përditshme kishte dalë një titull: "Grafite me përmbajtje fyese kundër UÇK-së". Në ato grafite të shpërndara në muret e një qyteti të Kosovës shkruante: "Poshtë UÇK-ja".

Nuk ishin dy vjet të plota që kishte përfunduar lufta dhe dikush mund ta mendonte këtë. Ka shumë shkaqe që kanë

mundur ta krijonin një klimë të tillë, ku disa persona mund ta merrnin guximin e ofendimit të një pjese të qytetarëve që mosnënshtrimin e kishin karakter dhe kauzë, prej atyre psikologjike e deri tek ato politike.

Pastaj erdhi një kohë kur në bisedat e përditshme dikush thoshte se "ata që kanë luftuar vërtet, kanë vdekur". Ishte fjala për ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Etimologjia e këtij formulimi është në thënien e serbëve për ne: "Një shqiptar i mirë është vetëm një shqiptar i vdekur".

Po ashtu, ka shumë shkaqe pse filluam që qëndrimet raciste për ne t'i "adaptojmë" në diskursin tonë të përditshëm, në cilësimin për veten. E Çuditshme, për të

mos thënë anomalike, se si erdhëm te një autoracizëm.

Këto dy raste, e shumë të tjera, janë tregues shqetësues se si ne i kuptojmë, ndërtojmë dhe trajtojmë vlerat tona të përbashkëta, si shoqëri që pretendojmë "perëndimore".

Sot udhëheqësit e UÇK-së i kemi në Hagë si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të shtetit serb për të relativizuar Çdo gjë dhe për t'i rishkruar përpjekjet dhe dhimbjen tonë për lirinë e vendit.

Shteti serb ka aktivizuar të gjithë mekanizmat dhe po përdor të gjitha mundësitë, kudo që i ka, për ta paraqitur luftëtarin e lirisë si dikush që nuk ka qenë.

Çka bëjmë ne? "Qesim petulla në ujë", nga një pseudo-diskurs

që idhnakësinë e luftën e ulët politike të brendshme ka busull. Të gjitha institucionet e shtetit, jo vetëm që nuk ndihmojnë, jo vetëm që heshtin, por tentojnë të pengojnë dhe diskreditojnë udhëheqësit e luftës sonë Çlirimtare që gjenden në Hagë. Gabim historik i një klase të papjekur politike.

Jo vetëm që po shkatërrojnë dinjitetin e një shoqërie të një konteksti shumë të rëndësishëm historik, e që është universal (lufta për liri), por po e mbjellin edhe farën e mosmirënjohjes. Farën më të poshtër për t'ju kundërvënë njëri-tjetrit.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës bëri historinë, ktheu dinjitetin përmes shembullit të mosnënshtrimit dhe hapi udhë

të rëndësishme për ta gjetur krenarinë shoqëria jonë.

Deri më sot UÇK-ja i ka penguar vetëm Serbisë, sepse ia ka prishur llogaritë e planit të saj fashist për Ballkanin.

Kush nga ne po i bëhet sot armik UÇK-së dhe cila është nevoja e këtyre politikanëve për një "performancë" kundër Çlirimtarëve?

Sa i marrë duhet të jetë njeriu që të mos dijë ta ndajë një vlerë të shenjtë të popullit tonë me luftën e përditshme politike?

Politika jonë është bërë "skënë ku defilojnë vetëm sedra të lënduara". Përtej kësaj nuk kanë shikim dhe mbi këtë po ndërtojnë verbërinë e tyre politike.

Perëndia ua ndriçoftë rrugën! Amin!

## Bilall Sherifi: Duam të dimë nëse mbrojtja e përfaqësuesve të UÇK-së është punë qeverie edhe tani, kur Kurti udhëheq qeverinë



*Deklaratë e sekretarit të përgjithshëm të Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, në konferencën për media të mbajtur më 5 maj në Prishtinë:*

*Të nderuar qytetarë të Kosovës, Të nderuar gazetarë,*

Siç patët mundësinë të shihni nga kjo video dyminutëshe, dhjetë ditë pas arrestimit të Jakup Krasniqit, Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, në cilësinë e udhëheqësit të opozitës së asaj kohe, gjatë konferencës për media të mbajtur më datë 15 nëntor 2020, kryetari i VV-së, Albin Kurti, ka deklaruar se: 1. Në Hagë nuk janë duke u përndjekur vetëm individët, sepse UÇK-ja nuk ka qenë e asnjërit, por e të gjithëve dhe që të gjithë duhet ta mbrojmë

atë. Shteti i Kosovës duhet ta organizojë e ta koordinojë mbrojtjen e të pandehurve. Ata, e pamë, kanë avokatët e tyre secili, mirëpo nevojitet bashkërendimi nga shteti.

Shtrojmë pyetje publike: Përse Albin Kurti heshti tërësisht gjatë procesit kur Gjykata Speciale duhej të vendoste lidhur me kërkesën e avokatëve për mbrojtjen në liri të përfaqësuesve të lartpërmendur të UÇK-së dhe përse nuk bashkërenditën së bashku me avokatët strategjinë e nevojshme për t'u siguruar atyre të mbroheshin në liri?

